



SHËRBIMI SOCIAL

BULETINI MUJOR

Tetor
2025

Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, po zbaton një nismë që synon kthimin e pasurive të sekuestruara në mbështetje konkrete për qytetarët në nevojë.

Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit kundër trafikimit të personave, Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH, znj. Reme Xholi, dhe Kryeadministratorja e AAPSK, znj. Risena Xhaja, zhvilluan vizita në disa institucione të përkujdesit shoqëror që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit, por jo vetëm, dhe një sërë pasurish të sekuestruara iu shpërndanë përfituesve të këtyre qendrave, duke u vënë në funksion të përmirësimit të kushteve të jetesës.



U zhvillua një tryezë pune që bashkoi 29 drejtues të institucioneve të përkujdesit shoqëror në varësi të pushtetit vendor dhe Shërbimit Social Shtetëror, me një qëllim të përbashkët: ofrimin e kujdesit cilësor, gjithëpërfshirës dhe dinjitoz për personat që kanë më shumë nevojë për mbështetje.

Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, znj. Reme Xholi, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm midis institucioneve të përkujdesit shoqëror dhe strukturave vendore për të siguruar shërbime sa më efektive dhe të unifikuara për përfituesit. Ajo vuri në dukje se përmirësimi i standardeve të përkujdesit kërkon komunikim të hapur, koordinim të ngushtë dhe përfshirje aktive të të gjithë aktorëve të sistemit të mbrojtjes sociale.



Në një atmosferë bashkëpunimi dhe reflektimi u zhvillua workshopi për prezantimin e Hartës së Shërbimeve Sociale 2025 – një instrument i fuqishëm në duart e qytetarëve, profesionistëve dhe politikëbërësve.

Për qytetarët: më shumë informacion dhe akses në shërbimet pranë vendbanimit.

Për politikëbërësit: vendimmarrje më të zgjuar dhe të bazuar në evidenca.

Për profesionistët: bashkëpunim dhe koordinim më i fortë në terren.

Zhvillimi i hartës së shërbimeve sociale dëshmon angazhimin e MSHMS dhe SHSSH për ndërtimin e një rrjeti kujdesi gjithëpërfshirës dhe dinjitoz për grupet në nevojë.



Në kuadër të 1 Tetorit, Ditës Ndërkombëtare të Moshës së Tretë, u realizua një tur ndërgjegjësues nga veriu në jug, ku mjeti ynë u përçoi qytetarëve të mbarë vendit mesazhin për vëmendje, përkujdes dhe dashuri për gjyshërit, sot e gjithmonë.

Në këtë rrugëtim na u bashkuan profesionistë të kujdesit social e shëndetësor, përfaqësues institucionesh, nxënës shkollash dhe vetë gjyshërit tanë, të cilët ndanë mesazhe të fuqishme për rëndësinë e respektit, përkujdesit dhe lidhjes së fortë ndërmjet brezave.



SHSSH me mbështetjen e Programit IADSA II, po zbaton në bashkëpunim me Qendrën ASET, Regione Marche dhe Regione Liguria projektin “eldEARLY – Përmirësimi i sistemit të përkujdesjes ndaj të moshuarve në Shqipëri”.

Në kuadër të këtij projekti kanë nisur zyrtarisht trajnimet e akredituara falas për dy profile të reja profesionale që po prezantohen për herë të parë në Shqipëri:

- Operatori i Asistencës Shtëpiake
- Operatori i Linjës së Këshillimit



Shërbimi Social Shtetëror

📍 Rruga e Durrësit, nr. 83, Tiranë, Shqipëri

☎ 044 54 18 21

✉ info@sherbimisocial.gov.al

🌐 www.sherbimisocial.gov.al